

VENDIM
Nr. 632, datë 10.10.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 893, DATË 27.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT ‘EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA’, NË KUADËR TË LËVIZJES OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 1, dhe 15, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 8, të nenit 11, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e projektit ‘Ekipet sportive në shkolla’, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Financimin, në masën 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë, të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), të ndarë:

a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;

b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023;

c) 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024.”;

b) Në pikën 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i. Fjalët “... *“Raiffeisen Bank, sh.a., me numër llogarie 0050249325 ...”* hiqen;

ii. Pas fjalëve “... për vitin 2023 ...” shtohen “... si dhe buxheti i miratuar për vitin 2024 ...”;

c) Në pikën 3 bëhen këto shtesa:

i. Pas fjalëve “... brenda muajit shkurt 2024 ...” shtohen “... si dhe brenda muajit shkurt 2025...”;

ii. Fjalët “... shkronjave “a” dhe “b” ...” zëvendësohen me “... shkronjave “a”, “b” dhe “c” ...”;

ç) Në fjalinë e dytë, të pikës 4, viti “2024” zëvendësohet me “2025”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku